MILOSAO

E diel, 26 Qershor 2011/ Redaktore përgjegjëse: Admirina PEÇI/ milosao2005@yahoo.com

Ditët e fundit të poetit

Isabelle: Vëllai im Artur Rembo

NGA ISABELLE RIMBAUD

90-vjetori i harruar

Si u krijua prefektura e Kosovës më 1921

NGA MAN POGA

ZBULIMI NGA NJE MOZAIK

Një sinagogë në Kalanë e Beratit?



Hans-Joachim Lanksch

Safo Marko? Kush është pa faj, le të hedhë gurin e parë ndaj saj

NGA FATMIRA NIKOLLI

Si e sheh një gjerman shqipfolës e përk thyes letërsinë shqiptare dhe debatet mbi të? Një ndër njerëzit më të afërt të Ca majt në mërgim rrëfen këndvështrimet e veta e ato të shkrimtarit shkodran për socrealizmin, Kadarenë dhe "mediokritetet" që shkruheshin këtu para viteve '90... Hans-Jachim Lanksch i ndjek rregullisht zhvillimet në Shqipëri. Ato mbi letërsinë, edhe më me shumë ëndje. Duket se ky është një zakon i hershëm që ia ka lënë profesori i tij, Martin Camaj. Prej Camajt, ai ka mësuar shumë për Shqipërinë, e mbi të gjitha ka mësuar shqipen, që e flet sot në standard, ama shpesh edhe në gegnisht. Në vazhdën e intervistave e mendimeve që së fundmi Gazeta ka marrë mbi letërsinë para viteve '90, i kërkuam një mendim edhe Lanksch-it, duke pasur parasysh se ai nuk është i përfshirë drejtpërdrejt në debat, sikundër është gjerman dhe interesat personale janë zero.

Kësisoj, ai tregon disa të vërteta që mbase s'i dinim, por thotë edhe ato që ne mbasi nuk mund t'i themi. E jo vetëm kaq, ai ofron edhe disa shkrime të viteve 1960, që hedhin dritë mbi mendimet e Camajt. Ndërsa vlerëson debatet që herë pas here zhvillohen në vendin tonë, ai thotë se "duhet me kenë i civilizuem, fjala e hapun nuk duhet të difamohet si hedhje ...

→ Në faqen 2

NGA DRITAN ÇOKU

Përhapja, mbijetesa dhe e ardhmja e Krishtërimit pjesërisht shpjegohet dhe me faktin që Jezuesi ishte hebre. Hebrenjtë patën zhvilluar një traditë unike fetare. Krishtërimi do të përthithte shumë ide prej tij. Nga pikpamja organizative, hebrenjtë u lanë të krishterëve të hershëm një kontribut të pasur: zakonin të mblidhen privatisht në godina të veçanta që quhen sinagoga, ku lexonin Shkrimet e Shenjta dhe më pas dëgjonin një bisedë për kuptimin e tyre. Nga këto sinagoga të krishterët nisën për së pari organizimin e tyre. (Sadik Bejko, Qytetërime të mëdha,f.257, 259)

Në studimin monografik të Prof. Dr. Shaban Sinanit në "Hebrenjtë në Shqipëri prania dhe shpëtimi" thotë se "ndryshe nga sa mendohet, lidhjet ...

→ Në faqen 4

Hulumtimi

Skicat

Fakte, analiza dhe hulumtime mbi gjurmët e hebrenjve në Berat. **Një studim përmes skicave që botohen për herë të parë. Çfarë tregojnë simbolet e mozaikut...**



Figura 2



Figura 3



Figura 4




Figura 5




Figura 6



Figura 7



Figura 8




Figura 1

Një sinagogë në kalanë e Beratit?

Dyshimet nga mozaiku në Kishën e Shën Kostandinit dhe Helenës.




Figura 10

DRITAN ÇOKU

Përhapja, mbijetesa dhe e ardhmja e Krishtërimit pjesërisht shpjegohet dhe me faktin që Jezuesi ishte hebre. Hebrenjtë patën zhvilluar një traditë unike fetare. Krishtërimi do të përthithte shumë ide prej tij.

Nga pikpamja organizative, hebrenjtë u lanë të krishterëve të hershëm një kontribut të pasur; zakonin të mblidhen privatisht në godina të veçanta që quhen *sinagoga*, ku lexonin Shkrimet e Shenjta dhe më pas dëgjonin një bisedë për kuptimin e tyre. Nga këto sinagoga të krishterët nisën për së pari organizimin e tyre. (Sadik Bejko, ***Qytetërime të mëdha***,f.257, 259)

Në studimin monografik të Prof. Dr. Shaban Sinanit në "***Hebrenjtë në Shqipëri prania dhe shpëtimi***" thotë se "ndryshe nga sa mendohet, lidhjet historike-kulturore midis shqiptarëve dhe hebrenjve ekzistojnë qysh prej antikitetit. Gjurmët e këtyre lidhjeve janë ruajtur në arkeologji, në etnologji, në besime e rite, në histori e kronika, dhe mbi të gjitha në arkiva. Katër janë ardhjet më të mëdha të hebrenjve në hapësirën shqiptare dhe të katra lidhen me periudhat më të njohura të rrezikimit të qenies së tyre kolektive:

1.Në shekujt e parë të erës së re, kur hebrenjtë merreshin si skllevër në ish-perandorinë romake (hebrenjte romaniotë);

2.Në periudhën e inkuizicionizmit perëndimor sidomos të atij spanjoll, në fund të mesjetës, në vitet 1492 e 1497(hebrenjtë safardikë);

3.Në periudhën e përndjekjes masive prej ish-perandorisë osmane pas dështimit të kryengritjes së udhëhequr prej "*mustical Messiah*" *Sabattai Zevi*;

4. Në periudhën e shpalljes së doktrinës naziste të demoraza-s (*"final solution"*) – hebrenjtë ashkënaz (gjermanikë)".

Në fakt, për analizimin që do të thellohemi më poshtë thelbësore është se në Berat dëshmohet prania në kohë të ndryshme e tri grupimeve të mëdha të hebrenjve: romaniotë, safardikë dhe ashkënazi.

Kam patur fatin të marr pjesë në disa ekspedita mbi njohjen më nga afër të gjendjes së monumenteve, *Katalogimit Informatik* të tyre në qarkun e Beratit, fotografimit dhe skedimit. Në punën time kam vlerësuar evidentimin e gjurmëve të vjetra dhe dëshmive duke i dokumentuar. Mbledhjen e mjaft elementëve arkitektonike, artistike të interierit dhe eksterierit në ndërtimet popullore, të gjinisë së banesave karakteristike të Beratit, objekteve të kultit ortodoks dhe atij mysliman. Këto elemente i kam skicuar, studiuar dhe zbërthyer duke i bërë një analizë më të thelluar. Një prej tyre është edhe mozaiku, i cili ka pasur një përdorim mjaft të gjerë sidomos në qendrat qytetare, ku spikasnin veprimtaritë e mëdha ndërtimore.

Nga studimi dhe zbërthimi jam munduar të analizoj simbolikat dhe motivet e përdorura në mozaikun e Kishës së Kostandinit & Helenës ku lexohen mjaft qartë, simboli i yllit të Davidit me konfigurim të dyfishtë, gjashtë petalet e zambakut (shoshan) dhe kulti i numrave hebreje. Kjo na bën të dyshojmë se mozaiku pjesë interieri sot i kishës së Kostandinit & Helenës i përket një sinagoge të një periudhë më të hershme sesa ndërtesa kristiane. Mendojmë se është realizuar një konvertim i kultit hebraik, në një objekt kulti kristian ortodoks, për ekzistencën e faltoreve palimpsestos.

Por çfarë të dhënash burimore kemi për ardhjen e hebrenjve në Berat?

Sipas Prof. Dr. Ferit Dukës në monografinë e tij ***"Berati në kohën osmane (shek.XVI-XVIII)"***,në qytetin e Beratit ishte vendosur edhe një bashkësi e vogël hebraike (yahudiyan tayfasi), ardhur me sa duket nëpërmjet Vlorës që nga fundi i shek.XV si pasojë e ndjekjeve nga qarqet antisemitike europiane.

Defteri përmbledhës i regjistrimit (mücmel) të sanxhakut të Vlorës (brenda të cilit përfshihej Berati) i përpiluar në vitin 1506, shënon për qytetin e Beratit 395 shtëpi të krishtera, 11 shtëpi hebraike dhe asnjë myslimane.

Kështu, ndërsa në defterin osman të vitit 1520 janë regjistruar rreth 25 shtëpi hebrenjsh, në defterin e vitit 1583 janë regjistruar 11 syresh. Gjatë shek XVI vërehet një tkurje demografike tepër e djeshme e bashkësisë hebraike të qytetit të Beratit. Ka mundësi që një gjë e tillë të lidhej me largimet e herë pas hershme të hebrenjve nga ky qytet për të kërkuar kushte më të mira banimi. Megjithatë, hebrenjtë e Beratit kishin sinagogën e vet.

Jo vetëm gjatë dhe pas inkuizicionit, por edhe në mesin e shekullit të 17-të pas dështimit të *"kryengritjes mesianike"* që pati udhëhequr për një çerek shekulli Sabbatai Zevi, qindra




Figura 9

e mijëra hebrenj u strukën në këndin më të largët të ish perandorisë. Pranohet në studime se Sabbatai Zevi kishte ngritur një tempull për veten dhe pasuesit e tij në Berat. Të tjerët thonë e shkruajnë se ai u varros në këtë qytet (*I.Ëerešnješ*), ndonëse kjo mbetet ende një tezë e paprovuar. (Shaban Sinani, ***Hebrenjtë në Shqipëri Prania dhe Shpëtimi,*** f.388)

Në fund të shek. XVII(viti 1685), numri i hebrenjve u shtua papritmas nëpërmjet vërshimit drejt Beratit të Hebrenjëve të Vlorës, si rrjedhojë e sulmeve shkatërrimtare të flotës venedikase kundër këtij qyteti.(Ferit Duka,***Berati në kohën osmane (shek.XVI-XVIII)***,f. 29)

Udhëpërshkuesi turk Evlija Çelebi, në veprën e tij, ***"SEJAHATNAME", (UDHËTIMET)*** prej 10 volumesh thotë: "*...Sipas regjistrimit në Berat gjenden gjithsej 30 lagje. Ndër to dhjetë lagje janë të krishtera, një çifute, por nuk ekzistojnë lagjet për armenët, për evropianët (fregjet) dhe për evgjitët.*"(Përkthimi është marrë nga libri "***Berati 300 vjet më parë***" Vafsi Samimi f.32,33). Ky fragment tregon qartë për besueshmërinë dhe vazhdimësinë e pranisë së këtij komuniteti.

Më pas osmanologu Ferit Duka vazhdon se në vitin 1708 numri i hebrenjve ishte pakësuar. Arsyet e këtij fenomeni tani për tani janë të paqarta për shkak të mungesës së të dhënave dokumentare. Njëri nga vendndgulimet e reja të kësaj popullsie duhet të ketë qenë edhe qyteti i Elbasanit.

Metropoliti i Shenjtë i Beratit Anthim Aleksudhi thotë:"*... në të kaluarën kishin banuar sipas dëshmisë së njerëzve më pleq rreth 100 familje çifutësh, por në kohën kur në Berat sundonte Ahmet Kurt Pasha, janë larguar për në Janinë? Pelagoni e gjetkë. Sipas thënieve këta kishin banuar në një lagje, ku tani janë banjat e qytetit*" (Anthim Aleksudhi, ***"Përshkrim i shkurtër i Metropolisë së Shenjtë të Beratit"*** Korfuz, 1868, f.28).

Po përpara fund shek. XV a ka gjurmë të hebrenjve në Berat?

Kontakti i parë i hebrenjve në hapsirën shqiptare ka qenë në shekujt e parë të erës së re, kur hebrenjtë merreshin si skllevër në ish-perandorinë romake, (hebrenjtë romaniotë). Ky vlen si argument ashtu siç e përmendëm edhe më lart edhe për praninë e hebrenjve në Berat që në atë kohë. Mendojmë se nuk do të kishte arsye që në qytetin e lashtë të Beratit nuk do të kishte zhvillime të historisë së komunitetit hebre. Qyteti i Beratit ka rrezatuar e dëshmuar prej shekujsh ndërthurjen e bashkëjetesës së qytetërimeve dhe kulturave ndërfetare.

Përveç këtij fakti kemi një errësirë në periudhën paleokristiane viti 30 - 787 e.s, si në të dhëna të tjera më të plota dokumentare për gjurmë të hebrenjve në Berat ashtu edhe nga mungesa e gërmimeve arkeologjike si burime shkencore. Mbetjet arkeologjike i konservon nëntoka e qytetit të fortifikuar kështjellë, ndërsa veçojmë disa fragmente arkitektonike të ripërdorur në kishat e kalasë së Beratit. Padyshim nevojitet intensifikim për një kërkim të pastër arkeologjik sepse kjo qendër është e përbërë prej shtresash të aktiviteteve të ndryshme në kohë. Ato do të bënin të njohur aspekte të pasurive historike, kulturore e artistike dhe do të plotësojnë fondin kulturor.

Goditja e parë e rëndë kundër rregullave të pavarura hebreje të përfaqësuar nga sinedrit dhe Patriarkanës, u vuajt në 427 e.s, nga dështimi i Teodosit të II që emëroi një pasues Gamalieli-të VI, si patriarkun e fundit. Por sinedrit vazhduan në rregullat e tyre. (http://**zeevgoldmann**.blogspot.com/2008/08/www-combined-six-petalled-and-three.html)

Përndjekjet kundër çifutëve ndodhën edhe në kohën e Leonit III (717-741), ndër të rrallat përndjekje antisemite të historisë bizantine, duhen konsideruar më shumë si një shenjë e forcimit të ndikimit hebraik në këtë kohë; duke filluar nga shek.VII, në letërsinë teologjike bizantine shfaqen gjithnjë e më shumë shkrime polemike në përgjigje të sulmeve hebraike kundër krishtërimit.(Georg Ostrogoski "***Historia e Perandorisë Bizantine***" f.14)

E prekëm historikisht periudhën e palco-krishtërimit dhe ngjarjet që kanë të bëjnë me hebrenjtë në këtë kohë jo pa qëllim, sepse mozaiku pjesë interieri sot i kishës së Kostandinit & Helenës mendojmë se i përket një sinagoge të shek.V-VI e.s (fig.8). Këtë hipotezë ne e mbështesim jo vetëm nga simbolikat, kuptimin e tyre në mitologjinë hebraike, ngjarjet të sjella kronologjikisht, burime të tërthorta pas viteve 70-135 e.s të hebrenjve në Berat, fakte të tjera që do ti shpreh im më poshtë, por edhe nga materiali i përdorur dhe teknika e punimit, si një mozaik i kohës së vonë antike.

OBJEKTI: Kisha e shën Kostandinit & Helenës

Ndodhet pranë shtëpive të banimit në anën perëndimore të lagjes "Kala". Objekti ruan piktura murale, të cilat datohen nga mbishkrimi si të vitit 1639. Mbishkrimi gjendet në faqen e murit verior të kishës së shën Kostandinit e Elenës, në Kala të Beratit. Kisha ka madhësi 8.70 x 7.80m (1639=data e themelimit, 1649= data e pikturimit). (Theofan Popa, ***Mbishkrime të kishave në Shqipëri***, f. 92) Në brendësi të kishës spikat dyshemeja me pllaka guri, tullash e zaje lumi. Dimensionet e saj janë 395 x 400 x 384 x 392cm. Kjo dysheme dekorative është mjaft interesante për motivet dhe simbolet. Evidentimi i tyre fillon nga qendra e emblemës. Me anë të gjashtë copa tullash fillojnë e shpërndahen nga qendra ku është vendosur një zall lumi dhe në mes tyre po nga një zall lumi i madh dhe nga tri zaje të vegjël.

Simbolet hebraike në objekte kulti të krishterë

"Kisha e shën Mëri Vllahernës" fillim shek.XIII është ndërtuar mbi strukturat e një kishe më të hershme dhe ripikturim nga Nikolla i biri i Onufrit viti 1578. Kisha më e hershme ruan strukturat e saj, sternën nga veriu dhe nga lindja ndodhen dritare 60cmx110cm ku kisha merrte burimin e dritës.



Figure 13: *Emblema qendrore e mozaikut në kishën e Shën Mërisë së Fjetur, sot Muzeu Ikonografik "ONUFRI", simboli i Yllit të Davidit. Kisha rindërtim i vitit 1797, mozaiku mendohet ti përkasi kishës më të hershme*



Figure 14: *Emblema qendrore "Kisha e shën Ilias" simboli i Yllit të Davidit, lagjja "Përroi" me toponimin e vjetër sot lagjja "13 Shtatori".*



Figure 15: *Simboli i yllit të Davidit në portën e hyrjes për në Teqenë e Helvetive, rindërtim i vitit 1782.*



Figure 16: *Simboli i yllit të Davidit në portën e hyrjes nga veriu për në Xhaminë Mbret, ndërtim nën përkujdesjen e Sulltan Bajazitit II (1481-1512) dhe pjesa e portikut rindërtim i fund shek.XVIII- fillim i shek. XIX.*

I gjithë ky motiv simbolik është një monogram me një yll me gjashtë cepa, iota (Ι) and chi (×), dy shkronjat e para greke të Jesus Christ (Ieus Christos) i vendosur në një rreth prej nëntë copa tullash,. Mendojmë se mund të jetë përdorur monogrami i krishtit (fig.2,3), disa e quajnë këtë simbol "Christogram".

Ky llojë kryqi pa trup rrethor, i njohur gjerësisht në periudhën paleokristiane si monograma e Krishtit, është simbol i vdekjes dhe Ringjalljes së Krishtit (ndërkohë është edhe kryqi i fitores). Ky kryq njihet si kryqi monogrametik, kristograma, monograma e Kostandinit, kriza dhe Kryqi i Vërtetë. Më herët në konceptin egjiptian forma e kryqit njihet si ylli që dëshmonte mëngjezin si dhe përtej jetën varrit. Në këtë rast futej në rrethi.(Gazment Muka, ***Rotonda e Durrësit***, f.15).

Do të vazhdojmë me përshkrimin e simboleve të mozaikut. Dy trekëndor të ndërthurur me njeri tjetrin formojnë një yll me gjashtë cepa, simbolin e yllit të Davidit (**fig.4**). Këtu janë të mbivendosur tri drejtkëndor me funde të harkuar që kanë për vijë simetrike tre boshtet që kalojnë në pikëprerjet e trekëndorëve. Nga ndërthurja e tre drejtkëndorëve krijohet sërish në miniaturë simboli i yllit të Davidit, i brendashkruar një gjashtëkëndori. Fundet me harqe të tre drejtkëndorëve formojnë një motiv simbolik, një lule me gjashtë petale të zambakut (shoshan) (**fig.5**).

Sipas *Dr. Ze'ev Goldmann* (1905-2010) i cili ndërron jetë pa përfunduar librin e tij rreth origjinës judeokristiane të yllit të Davidit shek. I-XI e.s thekson që Shoshan erdhi në jetë si stoli e lartë e artit hebre dhe sidomos në ornamente kube të Jeruzalemit. Zhytur në traditën judeo-krishtere, ai u bë një shoqërues i vazhdueshëm i Yllit të Davidit, dhe më vonë, të kryqi.

Këto simbole bëjnë pjesë në emblemën qendrore e cila është qarkuar me dy rreshta tullash ku trashësia e tyre është 3.5cm me një hapsirë midis tyre po 3.5cm e plotësuar me zaje lumi. Dy linjat rrethore përsëriten në hapësirën 43cm larg dy linjave të para. Në këtë hapësirë janë vendosur *20 pllaka qeramike katrore* 29cm x 29cm në mënyrë që kulmet e pllakave takojnë në linjat rrethore, dhe në hapësirat e tyre janë vendosur *40 pllaka guri trekëndore*. Në këtë emblemë ndodhet e përsëritur sikur për të na kujtuar numri 12-të si një numër i shenjtë hebre. 12-të kulmet e 2 yjeve të Davidit, japin 12-të rombe & 12 trekëndor. Me ndarjen e 6-të petaleve të zambakut (Shoshan) në skaje formohen 12-të trekëndor me njërën prej brinjëve të harkuar. Numrat 12-të, 20-të & 40-të kanë simbolikën e tyre në kultin e numrave hebre.

Kulti i 12-ës

Në Kabalah* konsiderohet si numër i shenjtë hebre, sepse përputhet me numrin që tregon 12 fiset izraelite. Konsiderohet si rezultat i përfituar pas shumëzimit të treshes (3) hyjnore dhe katërshja (4) tokësore.(Kabalah është një disiplinë dhe shkollë mendimi e lidhur me aspektin mistik të judaizmit rabinik. Është një bashkësi mësimesh ezoterike, për të shpjeguar marrëdhënien midis një krijuesi të përjetshëm e misterioz dhe universit të fundëm të vdekshëm (krijimit të tij).)

Kulti i 20-ës

Sipas ligjit të lashtë hebre, një person duhet të jetë njëzet (20) vjeç për t'u bërë një qytetar i rritur i cili ishte plotësisht përgjegjës për ligjin.(Eksodi 30:14; Numrat 26:24, 32:11)

Kulti i 40-ës

Tek hebrenjtë kulti i 40-ës lidhet me ndëshkimin e parë hyjnor të botës së zhytur në shthurje, dhe rifillimin e jetës së të gjitha gjallesave që ishin ruajtur në varkën e Noe-së,e cila qëndroi mbi ujë pikërisht 40 ditë. Si numër simpatik 40-a tek hebrenjtë lidhet edhe me traditën e *Shkrimeve*: 40 ditët e udhëtimit në shkretëtirë, 40 ditët e qëndrimit të Moisiut në malin e Sinait, 40 ditët e agjërimit – "*quaresima*" – *kreshma – të profetit Eliah* (dhe të Jezuit), 40 ditët e paralajmërimit të shembjes nga Gjoni, 40 ditët e rringjalljes dhe të ngjitjes së shpirtit në qiell.(Shaban Sinani, ***Hebrenjtë në Shqipëri Prania dhe Shpëtimi,*** f.23)

Një fakt tjetër mjaft i rëndësishëm për studimin tonë është edhe një fragment i murosur mbi absidën e kishës së vogël (shën Thomai) ngjitur me kishën e shën Todrit lagjja "Kala" – Berat(fig.9). Në vitin 1917 sipas austriakëve Kamilo Prashniker & Arnold Shober, arkeologë në Institutin Arkeologjik, Vjenë thonë se: *Guri i varrit (?) i dhënë në fig.75 është murosur mbi absidën e djathtë të kishës së vogël, që gjendet drejtpërdrejt prapa portës së qytetit të sipërm, majtas.Lartësia rreth 0.70 m gjerësi afërsisht 0.45m, gur gërqerr blu në gri, sipër i thyer. Në fushën e thelluar një kurorë me kokë poshtë, brenda së cilës një mbishkrim i fshirë.*(Kamilo Prashniker & Arnold Shober, ***"Kërkime arkeologjike në Shqipëri dhe Mal të Zi"*** f.64.)

Pas skicimit dhe rilevimit tim në vend ky fragment i murosur (fig.10) nuk përkonte me

dimensionet e ofruara nga dy arkeologët austriak dhe pjesërisht edhe me përshkrimin që i bëjnë këtij elementi. Dimensionet e sakta janë lartësia 55cm gjerësi 37cm. Në fushën e thelluar të kurorës me kokë poshtë brenda saj nuk ka mbishkrim të fshirë, por simbolin një yll me gjashtë cepa, dy trekëndor të ndërthurur, pra simbolin e Yllit të Davidit. Të jetë kjo ndonjë lajthitje e tyre?, pasi sipas një fotoje të vitit 1961 ky simbol është ende i lexueshëm. Simboli i Yllit të Davidit 10cmx10cm i cili ishte i punuar me reliev të ulët 2-3mm në gjendjen e sotme nuk duket sepse faktorët natyrorë (sidomos shirat) kanë bërë që në fushën e kurorës ku është punuar Ylli i Davidit ta dëmtojë dhe guri të gripohet. Ky fragment është i ekspozuar nga faktorët atmosferik dhe nuk ka ndonjë element strehe të dalë konsol për ta mbrojtur.

Si përfundim fragmenti i murosur për mendimin tim është një gur varri hebre. Këtu nuk niscm vetëm nga fakti i simbolit të Yllit të Davidit, por edhe nga kurora simboli i triumfit mbi vdekjen të cilën e gjejmë në gurë varri hebreje. Kurora është simbol i fitores. Ajo gjendet edhe në pllaka altari sinagoge të zbukuruara me këtë simbol.

Këtë simbol e gjejmë edhe në pamjen e sinagogës së Birim Kefar në Galile mbi derën qendrore kryesore.(H.A.MEEK, ***The synagogue,*** f.70,71)

Krahas kësaj analize i shtohet edhe një argumentim tjetër për mbështetjen e hipotezës sonë. Sinagogat nuk kanë patur vetëm karakter fetar. Në këto ndërtesa, përveç vendit të faljes kishte edhe qendra pushimi, mensa, bujtina, banja, qendra kulturore etj. Qëllimi i izraelitëve, ka qenë që të depërtonin në Perëndim. Sinagogat ndihmonin tregtarët që të lëvizninn nga Lindja drejt Perëndimit. Atje ku ndërtohej një sinagogë, ndërtohej një manastir, një bujtinë për veprimtari kulturore, anekse të tjera për ushqim, duke marrë një pamje madhore ku përfaqësohej plotësisht një kulturë, që kishte drejtimin nga Lindja në Perëndim.(Bardha Nergjoni ***Hebrenjtë e Elbasanit***)

Pra, duke u ngacmuar edhe ky detaj "***atje ku ndërtohej një sinagogë, ndërtohej një manastir***" marrim shkas dhe kthehemi në kohë rreth 340-vjet më parë. Udhëpërshkuesi turk Evlia Çelebi gjatë përshkrimit të portave të kalasë përshkruan edhe një portë tjetër rrëzë një manastiri të vjetër, që ka drejtimin nga perëndimi dhe komunikon me xhaminë e lagjes *Murad Çelebi*, që është ndërtuar rishtas prej *Hysejn Pashait*.

Gjurmët e këtij manastiri duken edhe sot përpara këtyre tre kishave të krishterë d.m.th edhe pranë kishës së shën Kostandinit dhe Helenës, por tani janë të lexueshme strukturat e mureve vetëm në sipërfaqen e terrenit.

A mos vallë në ambientet e këtij manastiri filloi shkolla e të shkruarit të kodikëve duke patur parasysh traditën e njohur në shkallë evropiane në Shkrimet e Shenjta?

Berati ishte për shekuj me rradhë një kryeqendër e krishtërimit në Ballkan. Ai është qyteti i mjeshtërisë së artit kishtar. Në mesjetën e hershme kishte gjashtë shkolla pikture dhe bukurshkrimi.(Shaban Sinani, ***Beratinus,*** f.161)

Megjithatë një ndihmesë mund të japin gërmimet arkeologjike të cilat janë burimet primare, pikërisht në sipërfaqen e sotme përpara këtij kompleksi, ku do të mund të na hedhin dritë mbi disa enigma në qytetin e fortifikuar kështjellë, por veçanërisht edhe për sqarimin e hipotezës sonë. Një gërmim i pastër arkeologjik profesional e shkencor, do të përbënte një gjetje me mjaft interes për këto vlera të jashtëzakonshme universale të lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me ngjarje të ndryshme me këto vlera të rralla.

Si përfundim mendoj se mozaiku element interiori i kishës së shën Kostandinit dhe Helenës i përbërë prej pllaka qeramike, copa guri dhe zaje lumi (dominojnë zajet e zinj) mund të jetë gjurma e një sinagoge. Kjo hipotezë na çon në faktin që ka ndodhur një konvertim i kultit hebraik me një objekt kulti kristian ortodoks.

Specialist (Skicograf) i D.R.K.K-Berat

Simbolet hebraike në objekte kulti islame

Pas pallatit pashai urdhëroi rindërtimin e Teqesë së Helvetive e për këtë qëllim thirri usta Dush Barkën nga Misrasi i Oparit. Ai sipas të dhënave gojore të kësaj zone, veç rikonstruksionit të Teqesë së Helvetive kryer me 1782- 1783, skaliti motivet e gurta mbi fasadë, pjesët e drunjta dhe stalagtitet e mihrabit, të afërta me stalagtitet e shek. 16 në gjithë Shqipërinë, (të tilla shihen edhe në xhaminë e Plumbit në Berat). Ky usta kreu më vonë dhe rindërtimin e hajatit të xhamisë "Mbret". Ne gjetëm të njëjtën vulë të Solomonit, që përsëritet në këto dy objekte, (fig.15,16), mbi murin e një kulle në Gjonbabas të Oparit, që sipas kodeve sekrete të mjeshtërve është zgjedhur si firmë e grupit të punës.(Fatbardha Shkupi, *Mjeshtrit popullorë në Berat gjatë shekujve 18-19 dhe fillimit të shek 20*, f.57).

Cilat janë dëshmitë e tjera të simboleve hebraike?

Mbreti Solomon në zbukurimoren e "Kodikut të 41-të të Beratit" – miniaturë (shekulli i 14-të fl.92 verso) f.18 Hebrenjtë në Shqipëri.



Figure 11: ***Monogrami i krishtit dhe simboli i 6- petaleve të zambakut (shoshan), simbol Judeo-kristian.***



Figure 12: ***Guri hexagonal (në qendër simboli i diellit) me brinjë të barabarta krijohen gjashtë trekëndor barabrinjës 3 me pllaka guri & 3 me qeramikë ku përftojmë simbolin e Yllit të Davidit.***



Figure 17: ***Tavani i banesës Irakli Xhimitiku me simbolin e Yllít të Davidit .***



Figure 18: ***Detaj tavani me simbolin e Yllit të Davidit në banesën e Vajde Myftiut. Banesa rikostruktuar në vitin 1852.***




Figure 19: *Simboli i Yllit të Davidit në rozetën e tavanit të një banese lagjja"Murad Çelebi*



Figure 20: ***Simboli i Yllit të Davidit në një banesë me një arkitekturë të spikatur Italiane, datimi 1943, lagjja"Murad Çelebi"***

Simbolet hebraike në tavanet e banesave karakteristike në Berat